



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.01.2024

Nr: 06

Ora: 11:00

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 04, DATË 29.12.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI "PARTIA ALEANCA POPULLORE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.01.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Aleanca Popullore

OBJEKT:

1. Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021".
2. Shfuqizimin e pikës 101, të vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021".

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Data: 12.01.2024 Nr: 06
Ora: 11:00



"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 04, datë 29.12.2023 të depozituar nga subjekti 'Partia Aleanca Popullore'"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti “Partia Aleanca Popullore”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 04 regj., datë 29.12.2023.

Në mbledhjen e datës 12.01.2024, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 04, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 04, datë 29.12.2023, të paraqitur nga subjekti “Partia Aleanca Popullore”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 12.02.2024, ora 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvin	Lako	-	Relator
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar